

# atrc

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Përkrah  
komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi IV • Numri 5 • Qershor 2006

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

OJQ-të diskutuan për procesion e decentralizimit

Shoqëria civile vazhdon të kontribuoj për qeverisje llogaridhënëse në Kosovë

“Shërbimet në hije të inteligjencës në Kosovë: Shpërbërje, Shkrijje apo Integrim?”

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme i bën thirrje OJQ-ve kosovare të paraqesin projekt propozime më kualitative

### Faqe 3

Fermerët tejkalojnë ndarjet etnike, formojnë kooperativë

Gazetarët kosovar protestuan në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit

Debate të inicuar nga OJQ-të: “Kosova në Evropë” “Dialogu Ndëretnik”

### Faqe 4

Koalicioni antikorrupsion i OJQ-ve shpërnda posterë, paralajmëron se Kosova mund të bëhet “Banana Republikë”

Besueshmëri më e madhe publike mund të arrihet me adoptim të Kodeve të Etikës

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

# AVOKUESI

## “Kosova shtëpia jonë”

### Shoqëria civile participon në diskutimin publik për draft “Planin Hapësinor të Kosovës 2005 - 2015+”

Drejtori i Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH), Ilir Gjinolli, shqyrtoi draft dokumentin “Planin Hapësinor i Kosovës 2005 - 2015+” me përfaqësues të shoqërisë civile gjatë një tryeze të organizuar nga ATRC-ja më 23 maj.

Nëpërmjet një prezantimi vizual, Gjinolli informoi pjesëmarrësit për strategjinë e zhvillimit hapësinor të Kosovës, e cila bazohet në: a) zhvillimin e një rrjeti të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik, b) zhvillimin dhe konservimin e resurseve natyrore, dhe c) zhvillimin e lidhjeve strategjike.

“Planin Hapësinor është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për zhvillim më të shpejtë ekonomik, përmirësim të kualitetit të jetës, dhe njëkohësisht të mbroj resurset natyrore dhe trashëgiminë kulturore”, ka deklaruar Gjinolli. Gjatë gjithë prezantimit, ai veçoi se ky dokument vazhdimisht do të jetë i ndryshueshëm.

Instituti për Planifikim Hapësinor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përpiluar këtë draft dokument. Aktualisht, publiku mund të sugjeroj

ndryshime dhe përmirësime të dokumentit, para se ai t’i dorëzohet qeverisë për miratim.

Planin Hapësinor i Kosovës 2005 - 2015+, i titulluar “Kosova shtëpia jonë”, është rezultat i punës së përbashkët ndërmjet qeverisë, ekspertëve të fushave të ndryshme dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, nën koordinimin e IPH-së.

*Qytetarët mund t’i dërgojnë komentet ose sugjerimet e tyre në: [komentet.planihapesinor@yahoo.com](mailto:komentet.planihapesinor@yahoo.com) ose [komentet.planihapesinor@ks-gov.net](mailto:komentet.planihapesinor@ks-gov.net)*



## “Evropë Pritna!”

Më 9 maj, më shumë se 50 fëmijë të Prishtinës përfunduan karnavalin e tyre në Kuvendin e Kosovës, duke valëvitur flamuj evropian dhe brohoritur “Evropë pritna”, për të shënuar kështu Ditën e Evropës.

Nxënësit e shkollës fillore “Faik Konica” takuan Kryetarin e Kosovës Fatmir Sejdiun, i cili premtoi se e ardhmja e tyre do të jetë në Evropë.

“Çdokush e quan Evropën kontinent të vjetër, por ju fëmijët jeni ata që do ta ripërtërin këtë kontinent”, ka theksuar Sejdiu.

OJQ “INTEGRA” ka organizuar këtë karnaval në kuadër të projektit të quajtur “Evropë Pritna!”. Ky projekt synon të promovoj lirinë e lëvizjes, ngrit vetëdijen për

procesin e integritit evropian, dhe të inicioj debate për këtë çështje ndërmjet qytetarëve dhe strukturave qeverisëse të Kosovës.



Takimi i Presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu me dhjetëra fëmijë më 9 maj, Ditën e Evropës

## Publikim i Ri

**“Shërbimet në hije të inteligjencës në Kosovë: Shpërbërje, Shkrimet apo Integrim?”**

Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) ka publikuar më 10 maj një publikim për shërbimet e inteligjencës në Kosovë.

Publikimi përfshinë informata për shërbimet e inteligjencës të partive politike dhe sfidat për një shërbim të tillë të Kosovës, siç është politizimi, marrëdhëniet ndër-institucionale, dhe hartimi i një kornize ligjore adekuat dhe të zbatueshme.

Ai po ashtu paraqet parimet e ndërtimit të shërbimit të ardhshëm të inteligjencës në Kosovë, siç janë krijimi i bazës ligjore, kufizimi i përgjegjësive, dhe hartimi i mekanizmave të llogaridhënies.

“Përderisa struktura e institucioneve të ardhshme të Kosovës është në shqyrtim e sipër, është çështje kohe kur do të shtrohet çështja e krijimit të shërbimit të inteligjencës të Kosovës. Mënyra se si do t’u vjen fundi organizatave të tanishme është thelbësore për zhvillimin e strukturës së re e cila duhet të ndërtohet si duhet, mbi themele ligjore, me mandat të qartë dhe me vija të qarta të llogaridhënies”, thuhet në këtë publikim.

Ky projekt është përkrahur nga Freedom House dhe USAID.

*Publikimi mund të lexohet në [www.kipred.net](http://www.kipred.net)*

**Mundësi financimi për OJQ**

**Qendra Ndërkombëtare Olof Palme i bën thirrje OJQ-ve kosovare të paraqesin projekt propozime më kualitative**

Koordinatori i Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme në Prishtinë, Levent Biçaku, informoi përfaqësues të OJQ-



*Për më shumë informata për fonde dhe procedurat e aplikimit të Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme, vizitoni [www.palmecenter.org](http://www.palmecenter.org)*

ve lokale për programet e Qendrës Palme, gjatë një takimi të organizuar nga ATRC-ja më 16 maj. Biçaku prezantoi objektivat dhe prioritetet e financimit, procedurat e aplikimit, sikurse edhe fondet në dispozicion për Ballkanin Perëndimor.

“Prioritet të financimit janë demokracia, të drejtat e njeriut dhe paqja”, Biçaku deklaroi. Ai tha se “Kosova do të jetë më prioritare për fondet rajonale të Qendrës Palme”. Ai u

bëri thirrje përfaqësuesve të OJQ-ve të paraqesin projekt propozime më të mira sepse “shanset për t’u financuar varen nga kualiteti i projekt propozimeve”.

15 gushti është afati i fundit për të aplikuar për fondet e sivjetme të Qendrës Palme.

Prezantimet e donatorëve janë pjesë e programit të ATRC-së, të cilat synojnë njohimin e OJQ-ve për mundësi financimi, dhe kontaktimin e donatorëve me OJQ-të, që kanë interesa të ngjashme.

**OJQ-të diskutuan për procesion e decentralizimit**

Lutfi Haziri, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal, njoftoi përfaqësues të OJQ-ve lokale për zhvillimet e fundit të procesit të decentralizimit në Kosovë, gjatë një tryeze më 26 prill. Takimi, i organizuar nga ATRC-ja, synonte të diskutohej kontributi i shoqërisë civile ndaj procesit të decentralizimit.

Haziri veçoi se qeveria e

Kosovës dhe Serbia po diskutojnë për reformim të pushtetit lokal, për t’i shërbyer më mirë nevojave të të gjithë qytetarëve.

“Parimet e delegacionit kosovar lidhur me decentralizimin janë të bazuara në marrëdhëniet ndëretnike për një ambient integruar”, ka thënë ai.

Decentralizimi i bazuar në shoqëri shumë etnike krijon

kushte për komuna funksionale dhe të qëndrueshme financiarisht, pohoi Haziri. Ai iu referua praktikave të suksesshme të decentralizimit në Maqedoni dhe Slloveni.

Pjesëmarrësit komentuan se Kosova nuk do të jetë stabile në qoftë se ndahet etnikisht.

**Shoqëria civile vazhdon të kontribuoj për qeverisje llogaridhënëse në Kosovë**

ATRC-ja ka organizuar më 12 maj një tryezë të rrumbullakët ndërmjet Ramush Haradinajt, kryetar i partisë politike “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK,” dhe organizatave joqeveritare, për të diskutuar zhvillimet e fundit politike në Kosovë.

Haradinaj ka vlerësuar rolin që shoqëria civile po luan për zhvillime të suksesshme në Kosovë, duke i bërë thirrje të “vazhdoj të kontribuoj për një qe-

risje më të mirë dhe më llogaridhënëse”.

Pjesëmarrësit sugjeruan se partitë politike duhet ta kuptojnë më mirë rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile. Ata përmendën problemet me të cilat po ballafaqohet shoqëria kosovare, siç janë papunësia, protestimet e studentëve në Universitetin e Prishtinës dhe korrupsioni në institucionet publike.



*Ramush Haradinaj gjatë diskutimit të zhvillimeve të fundit politike në Kosovë me OJQ-të lokale, më 12 maj*

## Debate të inicuar nga OJQ-të

### “Kosova në Evropë”

ATRC dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka organizuar më 18 maj diskutim publik ndërmjet Stephen Heintz, kryetar i Rockefeller Brothers Fund dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, të quajtur “Kosova në Evropë”. Diskutimi u përqendrua në zhvillimet e negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës, integrimin në Bashkimin Evropian, marrëdhëniet ndëretnike, si dhe rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në përkrahjen e dialogut zyrtar.

“Rockefeller Brothers Fund do të vazhdoj të fokusohet paraprakisht në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi, duke ruajtur fleksibilitetin për të përkrahur përpjekje të tjera rajonale dhe tej-kufitare”, ka deklaruar Heintz.

*Për më shumë informata, vizitoni [www.rbf.org](http://www.rbf.org)*



*Përfaqësues të RBF-së dhe shoqërisë civile diskutuan për situatën në Kosovë më 18 maj*

### “Dialogu Ndëretnik”

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe qeverisë diskutuan më 11 maj çështjen e dialogut ndëretnik, të cilin ata e konsiderojnë parakusht për stabilitet dhe prosperitet në Kosovë. Kjo çështje u diskutua gjatë një tryeze në Prishtinë me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, të organizuar nga Iniciativa për Ballkanin Perëndimor.

*Për më shumë informata, kontakti Inicativën për Ballkanin Perëndimor: 038 247 689*

## Fermerët tejkalojnë ndarjet etnike, formojnë kooperativë

Fermerë shqiptarë dhe serb kanë jetuar në fqinjësi me njëri tjetrin për dekada në komunën e Rahovecit. Ata punonin tokën e tyre dhe prodhimet i shitnin në mënyrë të pavarur. Me vetëm pak tokë, nganjëherë shitja e prodhimeve ishte e vështirë.

“Mbledhja dhe shitja e produkteve bujqësore është shumë e vështirë për fermerët. Kooperativa u siguron atyre vendin për të mbledhur dhe shpërndarë këto produkte, gjë që u mundëson shitjen më të lehtë të prodhimeve”, ka thënë Sylejman Balaj, fermer dhe kryetar i kooperativës “Agropok”.

Qendra Kosovare për Zhvillim (KDC), një OJQ nga Gjakova, e cila synon të përmirësoj ekonominë sociale të komuniteteve agrare, ka filluar implementimin e një projekti vjeshtë e kaluar për të përkrahur një kooperativë të grupeve të ndryshme etnike në Rahovec.

KDC ka asistuar takimet ndërmjet fermerëve të grupeve të ndryshme etnike, ka ofruar trajnime në fushën e bujqësisë, dhe ka tentuar t’u ofroj përkrahje sa herë që u është nevojitur. KDC-ja po

ashtu u ka ndihmuar fermerëve në përgatitjen e statutit të tyre në mënyrë që të mund të regjistrohen.

“Ata kanë vendosur të punojnë së bashku”, ka sqaruar drejtori ekzekutiv i KDC-së, Ismet Isufi. “Ne nuk i kemi shtyrë të veprojnë në këtë mënyrë. Ne vetëm i kemi ndihmuar”. Ai sqaroi se komunitetet duhet të vendosin vetë për bashkëpunim. Përderisa OJQ-të mund t’u ndihmojnë, ato nuk mund të imponojnë këtë proces, ka thënë ai.

Pas afro gjashtë muajsh bisedimesh jozyrtare, 20 fermerë të Rahovecit zyrtarisht regjistruan në maj kooperativën e tyre bujqësore, “Agropok”. Me qëllim që kooperativa të funksionoj, secili fermer është dashur të dhuroj tokën e tij, pak para dhe të pajtohet për organizim të përbashkët.

Kjo kooperativë është e para e këtij lloji në Kosovë. Drejtor ekzekutiv i saj është një serb, Marjon Šaciq, ndërsa kryetar është një shqiptar, Sylejman Balaj. Gjithsej janë tetë antarë serb



*“Kooperativa u mundëson fermerëve shitje më të lehtë të prodhimeve të tyre”*

dhe dymbëdhjetë shqiptarë. “Kooperativa do të punësojë persona të tjerë për shërbime bujqësore, mbledhje fermerët së bashku dhe ofroj atyre trajnime dhe konsulentë”, ka deklaruar Balaj.

Puna së bashku ofron shumë beneficione për fermerët. Ata mund të blejnë lëndën e parë dhe punojnë tokën së bashku, gjë që zvogëlon shpenzimet individuale të fermerëve. Duke i bashkuar prodhimet e tyre, ata mund të shesin me shumicë dhe kështu të fitojnë më shumë. Sipas Isufit, marrëveshja e këtyre fermerëve mund ti motivoj komunitetet e tjera për të punuar së bashku në të ardhmen.

Ky projekt është mundësuar me përkrahjen e Fondacionit për Iniciativa Demokratike, financiar nga USAID.

## Gazetarët kosovar protestuan në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit

Dhjetëra gazetarë të Kosovës protestuan kundër Udhëzimit Administrativ për implementim të Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare gjatë një gjysmë ore para ndërtesës së qeverisë në Prishtinë.

Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) organizoi këtë protestë më 3 maj për të shënuar Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit.

“Ky udhëzim nuk e realizon qëllimin për të cilin është lëshuar, pra nuk mundëson qasje të lehtë në dokumentet



World Press Freedom Day



zyrtare”, ka thënë Fatos Bytyçi, kryetar i AGPK-së.

Në shenjë pakënaqësie me Udhëzimin Administrative, i nënshkruar në prill nga Ministria e Shërbimeve Publike, gazetarët në fund të

protestës hodhën kopje të këtij dokumenti në shportë mbeturinash dhe i dogjën ato.

Dita Botërore e Lirisë së Shtypit është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 1993 në kohën kur demokritë e reja të dala nga Lufta e Ftohtë filluan përpjekjet për të ndryshuar ish sistemin qeverisës. Me shpalljen e kësaj dite synohej vënia në pah e zhvillimit të një prej institucioneve më të rëndësishme shtypit të lirë.



**Drejtoreshë Ekzekutive**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave & Administratës**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Menaxher i Shërbimeve të Trajnimeve & Konsulencave**  
ILIR HOXHA  
ilir@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
MERITA BARILEVA  
merita@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Menaxhere për Komunikim & Ndërlidhje**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Bashkëpunëtore e Programit**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**Menaxher për IT dhe Databasë**  
ARMEND SUSURI  
armend@advocacy-center.org

**Rr. Agim Ramadani Nr. 15**  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244  
810

## Koalicioni antikorrupsion i OJQ-ve shpërndau posterë, paralajmëron se Kosova mund të bëhet “Banana Republikë”

Koalicioni antikorrupsion ka shpërndarë posterë në mbarë Kosovën më 8 maj, duke i informuar kështu qytetarët për rreziqet që struktura aktuale e korruptuar politike paraqet në vend. Ky aktivitet është pjesë e një fushate të implementuar nga “Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet - Çohu” dhe OJQ lokale partnere të saj.

Në posterë shkruar “Rreth Korrupsionit të Përbashkuar” dhe “Banana Republic of Kosova”, për të treguar “kontrastin në mes të frazave patriotike të politikanëve dhe rrezikut real në të cilin ndodhet Kosova në rrugëtimin e saj drejt një mënyre kuazi-mafioze të qeverisjes”, thuhet në njoftimin për media të Çohu-të.

Koalicioni antikorrupsion është themeluar më 4 maj dhe në të përfshihen këto OJQ lokale: Çohu, Urban FM, Iniciativa Qytetare e Llapit, Iniciativa për Paqe, Qendra Rinore e Dragashit, Fisnikët, Elita, Kcic, Lëvizja Alarm, Sindikata e Pavarur e KEK-ut, Syri i Vizionit, Avonet dhe Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë.

For more information, contact [organizata-cohu@yahoo.com](mailto:organizata-cohu@yahoo.com)



### **Ngritja e besueshmërisë ndaj OJQ-ve**

## Besueshmëri më e madhe publike mund të arrihet me adoptim të Kodeve të Etikës

Në mesin e publikut të përgjithshëm, më të besueshme janë ato grupe, për të cilat fitimi nuk është qëllimi kryesor. Prandaj OJQ-të janë më të besueshme sesa kompanitë. Besueshmëria është pjesë e pandashme dhe thelbësore për marrëdhëniet dhe imazhin e OJQ-ve.

Besueshmëria publike ndaj OJQ-ve buron nga dy burime kryesore: performimi dhe llogaridhënia. Performimi do të thotë vlera të dobishme sociale të in-korporuara në projekte, të cilat përkrahin ndryshimet pozitive dhe të qëndrueshme. Kodet e etikës

për OJQ-të janë një ndër mjetet që mund të mbështesin llogaridhënen.

OJQ-të duhet të adoptojnë kode të etikës për dy arsye. Kodet mund t'i mbrojnë OJQ-të nga kritikët se janë të fshehta, jo transparente lidhur me burimet e financiare

mit, me pak masa të rrepta për procedurat dhe praktikën e menaxhimit, dhe pa procese demokratike. Duke themeluar standarde definitive të sjelljes etike, qeverisje të përbashkët dhe transparencë financiare, kodet u mundësojnë OJQ-ve krijimin e bazave mbështetëse dhe u sigurojnë kredibilitet dhe autoritetet më të madhe për aktivitetet e tyre.

Në disa vende OJQ-të punojnë në bazë të kodeve të etikës.

Burimi: Qendra Hulm-tuese për Zhvillim Global



Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.